

# UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

## FAKULTETI JURIDIK

### Studimet Master - DREJTIMI FINANCIAR

Kandidatja: Valerina Rrustemi

Mentori: Prof. Ass. Dr. Artor Nuhiu

Titulli i temës: Roli i qeverisjes korporative në cilësinë e raportimit financiar të organizatave biznesore në Kosovë

#### Abstrakt

*Qëllimi i këtij punimi është hulumtimi në rolin e qeverisjes korporative në cilësinë e raportimit financiar të organizatave biznesore në Kosovë. Përmes hulumtimeve dhe kërkimeve të shumta kuptuam rëndësinë dhe impaktin që kanë raportet financiare respektivisht cilësia e tyre në qeverisjen korporative. Studimi gjeti dallime ndërmjet cilësive të raporteve financiare, atyre raporteve të cilat kanë cilësinë e duhur për të ndikuar në qeverisje korporative në mënyrë efektive, efikase dhe profesionale. Ndërsa raportet financiare të cilat nuk kanë cilësinë e duhur, ato shfaqin mungesë informacioni dhe falimentime të organizatave biznesore, prandaj cilësia e raportimit financiar ka rolin primar për qeverisje të avancuar korporative.*

*Gjithashtu, hulumtimi gjeti se në mungesë të tregut të kapitalit në vendin tonë në Kosovë, përpjekjet për të pasur qeverisje profesionale korporative janë të vazhdueshme dhe roli i qeverisjes korporative në cilësinë e raportimit financiar ndjek trendet evropiane duke synuar konkurueshmeri me cilësi të raporteve financiare të korporatave evropiane.*

*Përkundër kësaj studimi arriti në përfundim se roli i qeverisjes korporative në cilësinë e raportimit financiar të organizatave biznesore në Kosovë është duke u rritur në një nivel më të arrirë në aspektin financiar dhe ekonomik. Këto gjetje mund të përdoren për të thelluar njohuritë tona për cilësinë e raportimit financiar të qeverisjeve korporative dhe organizatave biznesore në Kosovë.*

**Fjalët kyçe:** *Qeverisje korporative; cilësia; raportimit financiar; organizata biznesore; Kosovë, sfida; korporata.*